

recetë. Mjekut i duhet të shkruajë “utan tillstånd, betalas av region” në katrorin mbi dozë të recetës tëndë që ti të mos kesh nevojë të paguash shumën e plotë. Po që se ke recetë që është printuar deri sa ti ishe azilkërkues atëherë ti duhet të kërlesh nga mjeku yt të shkruajë një recetë të re, pasi që kartela LMA të ketë skaduar.

Ditari yt mjekësor (anamneza)

Ti ke të drejtë të kërlesh që ditari yt mjekësor (anamneza) të printohet në letër, kontakto personelin mjekësor dhe ata do të ndihmojnë me këtë.

Përkthyes

Ti ke të drejtë të shërbehesh nga një përkthyes.

Në rast sëmundje akute:

Shko te reparti më i afërm i urgjencës! Telefono 112 nëse të duhet.

Në rast sëmundje akute:

Shko deri te reparti më i afërm i urgjencës!

Telefono: 112 nëse të duhet

Ambulanca: 112

Këshillim mjekësor: 1177, është i hapur 24 orë

Ke nevojë për ndihmë ose dëshiron të informohesh më gjerësisht, atëherë kontakto ndërmjetësimin mjekësor të Kryqit të Kuq në:

Telefonin: 020-21 10 00 hënë-premte,
në orën 09:00-12:00 (falas)

E-mail: papperslos@redcross.se

Sms: 072-349 98 08 (Vetëm sms, telefono në numrin
020-21 10 00 nëse do të flasësh me ne)

Adresa për vizita:

Stockholm: Lindhagensgatan 126, 112 51 Stockholm, kati 4

Göteborg: Rullagergatan 6b, 415 05 Göteborg



Co-funded by
the European Union



Vård för papperslösa
och andra migranter

Swedish Red Cross

Infoservice 0771-19 95 00

E-post: info@redcross.se | www.rodakorset.se



Swedish Red Cross

Persona pa lejeqëndrim, sipas ligjit, kanë të drejtë në shërbime mjekësore.

Që nga viti 2013 migrantë pa lejeqëndrim kanë të drejtë në shërbime shëndetësore dhe mjekësore sipas ligjit 2013:407.



Swedish Red Cross

www.rodakorset.se

E drejta në shërbime mjekësore

Të rritur

Ti ke të drejtë në shërbime mjekësore si dhe azilkërkuesit tjerë të rritur, gjë që nënkupton të drejtë në përkujdesje shëndetësore që nuk mund të pres (përkujdesje shëndetësore që nuk mund të shtyhet për më vonë). Këtu përfshihet edhe përkujdesja ndaj dhëmbëve, përkujdesja somatike, përkujdesja psikiatrike si dhe për mjete ndihmëse. Përkujdesja shëndetësore gjatë shtatzënisë dhe lindjes, këshillim mbi mjete preventive, përkujdesje shëndetësore në rast abortimi, kontroll shëndetësor si dhe përkujdesja shëndetësore sipas ligjit për mbrojtje nga infektimet janë çdoherë falas. Pos këtyre rajoni administrativ mund të ofrojë më shumë përkujdesje, deri në nivelin e njëjtë me banorët e vendit. Personeli mjekësor që do të takosh do të vlerësojë nëse përkujdesja mjekësore ndaj teje mund të pres apo jo.

Fëmijët

Të gjithë fëmijëve që qëndrojnë në Suedi do t'u ofrohet përkujdesje e njëjtë mjekësore si dhe fëmijëve me banim të përhershëm, e që do me thënë përkujdesje të plotë shëndetësore, bile dhe përkujdesje ndaj dhëmbëve. Fëmijët duhet të regjistrohen te shërbimet dentare popullore dhe në klinikën për fëmijë (BVC) që të ftohen për kontrolla, këtë mund ta bëni ju vetë si prind.

Çka do me thënë përkujdesje mjekësore që nuk mund të

pres (përkujdesje që nuk mund të shtyhet për më vonë)?

Përkujdesje që nuk mund të shtyhet për më vonë është një nocion i përkujdesjes shëndetësore që përfshin tërë atë përkujdesje shëndetësore që mund të ofrohet në mënyrë që të mos sëmuresh më shumë se sa që je. Këtu inkluadrohet edhe trajtimi në vazhdim. Ti pra ke qasje në përkujdesje shëndetësore edhe më shumë se sa ajo akute. Përkujdesja shëndetësore që nuk mund të shtyhet për më vonë, me fjalë tjera do me thënë: kërko përkujdesje shëndetësore kur ti të kesh nevojë për të.

Pagesat

Pjesa më e madhe e shpenzimeve paguhet prej shtetit. Pjesën që ti vetë duhet të paguash quhet taksë pacienti. Mund të kërkossh faturë nëse nuk ke mundësi të paguash taksën e pacientit.

- Kontroll mjekësor në klinikë ose urgjencë të afërm: 50 kr
- Vizitë në urgjencë: 50–500 kr, varësisht se në cilin vend në Suedi jeton
- Vlerësim dentisti: 50 kr
- Tërheqja e ilaçeve në barnatore: 50 kr
- Mjete ndihmëse: prej 50 kr
- Udhëtim shëndetësor: 25 kr
- Falas:
 - Kontroll mjekësor
 - Përkujdesja shëndetësore sipas ligjit për mbrojtje nga infektimet

- Përkthyes
- Abortim
- Akusheri, përfshirë këtu edhe lindjet

Është mirë ta dini

Reservnummer

Kur ti për herë të parë kërkon përkujdesje shëndetësore ty të jipet një i ashtuquajtur rezervnummer. Ruaje këtë numër që do përdoret për të mbledhur të dhënat tua në ditarin mjekësor në një vend dhe është i rëndësishëm që ti të marrësh përkujdesje sa më të mirë shëndetësore. Numrin ti e përdor edhe kur statusi yt juridik ndryshon, si p.sh. nëse ti kërkon azil. Numri ndërkaq nuk zbulon se ti je person pa lejeqëndrim, prandaj dhe për këtë ti vetë i tregon personelit të përkujdesjes shëndetëore. Nëse ti më parë kishe një numër porse e ke humbur atë atëherë ti mund t'i tregosh personelit të përkujdesjes shëndetësore, ata në të shpeshtën e herave mund ta gjejnë atë në sistemin e tyre kompjuterik.

Identifikimi

Është mirë që ti të kesh me vete një dokument identifikues, si për shembull një letërnjoftim, LMA kartelë të mëhershme, pashaportë ose kopje të letërnjoftimit kur të kërkojnë përkujdesje shëndetësore. Në qoftë se nuk ke dokument identifikues ti megjithatë ke të drejtë në përkujdesje shëndetësore. Nuk do të kërkohet ndonjë dëshmi që vërteton se ti je i pa lejeqëndrim.

Të dhëna kontaktuese

Shërbimeve mjekësore mund t'u duhet nganjëherë të të kontaktojnë dhe prandaj të pyesin shpesh për ndonjë adresë ose numër telefoni. Po që se nuk ke adresë atëherë ti mund t'u japësh numrin e telefonit. Nëse nuk di të flasësh suedisht mund t'u japësh numrin e telefonit të dikujt që flet suedisht dhe që ata mund të kontaktojnë. Po që se ke një % adresë është me rëndësi që ti të cekësh emrin e personit që figuron në derë. Nëse shpërngulesh shpesh do të ishte mirë që të japësh një numër telefoni në mënyrë që të mos humbasësh kontakte me shërbimet mjekësore.

Sekreti profesional

I tërë personeli mjekësor është i obliguar të mbajë sekrete dhe shërbimet mjekësore nuk kanë të drejtë të kontaktojnë autoritetet shtetërore, si për shembull Entin për Migracion ose policinë.

Barnatore dhe recetë

Recetat elektronike duhet t'i dërgohen ndonjë barnatoreje specifike dhe ty të duhet një dokument identifikues për të tërhequr ilaçet e tua. Nëse nuk ke dokument identifikues ti atëherë duhet të kërkojnë që receta të printohet në një recetë formular. Në shumë vende të Suedisë ti duhet të paguash 50 korona për datën që receta yte është printuar, prandaj dhe kërko nga mjeku yt që të shkruaj recetën në të njëjtën datë, ashtu që ti të paguash vetëm 50 korona për çdo